Buletini informativ nr. 24 – 1 prill 2021 - 30 qershor 2021

- Hyrje
- Fushatë publike
- Seancat e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut
- Vendimet e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut
- Publikimi i vendimeve të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Hyrje

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut ("Paneli"), i themeluar nga Bashkimi Evropian në vitin 2009, është një organ i pavarur llogaridhënës me mandat që të shqyrtojë shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë ushtrimin e mandatit të tij ekzekutiv. Paneli publikon buletinin informativ në mënyrë periodike, në anglisht, shqip dhe serbisht, si pjesë e kontaktit me qytetarët në Kosovë, shoqërinë civile dhe komunitetin ndërkombëtar.

Paneli ka pranuar dyqind e një (201) lëndë prej se ka filluar punën e tij në qershor të vitit 2010. Paneli ka konstatuar që EULEX-i Kosovë ka kryer shkelje të të drejtave në pesëdhjetë (50) lëndë. Përpos kësaj Paneli ka konstatuar se nuk ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut në gjashtëmbëdhjetë (16) lëndë të tjera, të cilat i ka konsideruar të pranueshme. Paneli gjithashtu ka lëshuar njëzet e nëntë (29) vendime përcjellëse në njëzet e katër (24) lëndë në të cilat ka vlerësuar shkallën në të cilën Misioni kishte zbatuar rekomandimet e tij. Në shumë raste, Paneli konstatoi se zbatueshmëria ishte vetëm e pjesshme. Disa raste kanë bërë që të lëshohen vendime të njëpasnjëshme pasuese.

Lëndët pranë Panelit kanë të bëjnë me një sërë faktorësh thelbësor dhe procedural të të drejtave të njeriut, në thelb përfshirë të drejtat e jetës, respektimin e jetës private dhe familjare, dhe të drejtën për një mjet efektiv juridik. Pjesa e plotë e praktikës gjyqësore gjendet në: https://hrrp.eu/alb/cases.php.



Fushata informuese nga Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Raporti i ndërmjetëm

Në prill të vitit 2021, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut publikoi një raport të titulluar "Llogaridhënia e të Drejtave të Njeriut në kontekstin e Misionit të EULEX-it për Sundimin e Ligjit - Vlerësimi i Përkohshëm".

Qëllimi i këtij raporti është i trefishtë: të sigurojë një llogari të hollësishme të punës së Panelit deri më tani; të sigurojë mësime të marra - pozitive dhe negative - dhe rekomandime për përgjegjësinë e të drejtave të njeriut për çdo mision të ardhshëm ndërkombëtar të sundimit të ligjit; dhe, të nxjerrë në pah fushat e përmirësimit për misionin e EULEX-it Kosovë për sa i përket përgjegjësisë së tij ndaj të drejtave të njeriut për pjesën e mbetur të mandatit të tij.

Raporti ka për qëllim të jetë me rëndësi për Misionin dhe autoritetet e BE-së, shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta kontribuese, autoritetet e Kosovës, komunitetin diplomatik, organizata të tjera ndërqeveritare, studiues dhe praktikues të të drejtave të njeriut, dhe shoqërinë civile si në Kosovë ashtu edhe ndërkombëtarisht.

Videot

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut publikoi dy video të shkurtra informuese gjatë tremujorit të dytë të vitit 2021. Qëllimi i këtyre videove është që të informojë në lidhje me Panelin dhe punën e tij, veçanërisht në mesin e popullatës vendore në Kosovë, në përputhje me mandatin e Panelit. Të dy videot u publikuan në anglisht, shqip dhe serbisht.

Ne prill 2021, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut publikoi një video të parë informuese. Kjo video e parë shpjegon me terma të thjeshtë, "*Si mund të bëni një ankesë në Panelin për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut?*"

Në maj 2021, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut publikoi një video të dytë informuese. Kjo video e dytë përshkruan: *"Çfarë bën Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut me ankesën tuaj?"*

Këto dy video u botuan në faqen e internetit të Panelit, në Facebook dhe në LinkedIn.

Të dy videot mund të gjenden në: https://hrrp.eu/videos.php

Seancat e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2021, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut mbajti dy seanca. Paneli ka marrë vendimet përmes mjeteve elektronike për shkak të pandemisë Covid-19.

• Seanca e 50-të: 29 prill 2021;
• Seanca e 51-të: 29 qershor 2021.

Vendimet e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Në këto dy seanca, Paneli shpalli dy raste të pranueshme. Në të dyja këto raste, Paneli gjithashtu vlerësoi meritat e ankesave dhe gjeti se Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë kishte shkelur detyrimet e tij ndaj të drejtave të njeriut në lidhje me ankuesit. Paneli gjithashtu formuloi rekomandime për shefin e Misionit.

Për më tepër, në katër vendime mbi meritat, Paneli gjeti që Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë kishte shkelur detyrimet e tij ndaj të drejtave të njeriut në lidhje me ankuesit dhe Paneli formuloi rekomandime për shefin e Misionit.

Në tre raste kur Paneli kishte gjetur më parë një shkelje, Paneli lëshoi vendime pasuese për të shqyrtuar dhe vlerësuar zbatimin e rekomandimeve të tij nga shefi i Misionit të EULEX-it dhe për të bërë rekomandime të mëtejshme kur zbatimi nuk ishte i plotë ose i kënaqshëm. Paneli vendosi t'i mbajë të hapura të trija këto raste për përcjellje të mëtejshme të mundshme.

Vendimet e pranueshmërisë

• Lënda 2016-19 Dušan Milosavljević-i kundër EULEX-it. (Shih më poshtë në vendimet mbi meritat).

• Lënda 2016-32 Biljana Đorđević-i kundër EULEX-it. (Shih më poshtë në vendimet për meritat).

Vendimet për meritat

- Lënda 2016-16 Dobrivoje Vukmirović kundër EULEX-it. Më 29 qershor 2021, Paneli ka lëshuar Vendimin dhe Gjetjet. Në vendimin e tij, Paneli vendosi që EULEX-i kishte dështuar të kryejë hetim efektiv për zhdukjen e anëtarit të ngushtë të familjes së ankuesit dhe kishte dështuar ta mbante të informuar ankuesin. Si rezultat, Paneli gjeti që Misioni ishte përgjegjës për një shkelje në pjesën procedurale të së drejtës së ankuesit për jetë, të garantuar me nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe për shkeljen e së drejtës së ankuesit për mos t'iu nënshtruar trajtimeve çnjerëzore e poshtëruese, siç garantohet me nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paneli gjithashtu gjeti që Misioni ishte përgjegjës që nuk i ka siguruar ankuesit një mjet efektiv juridik, në kundërshtim me nenin 13 të Konventës. Paneli i bëri disa rekomandime shefit të Misionit të EULEX-it, duke përfshirë që t'i pyes autoritetet se çfarë hapash janë ndërmarrë për të hetuar rastin dhe që t'u theksojë autoriteteve rëndësinë e të drejtave të viktimës për të vërtetën dhe që të informohet për rrjedhën e përgjithshme të hetimi. Paneli gjithashtu ftoi shefin e Misionit të kontaktojë ankuesin në mënyrë që të gjejë një mjet juridik për shkeljen e të drejtave të tij. Zbatimi i Misionit i atyre rekomandimeve është ende në pritje.

- Lënda 2016-19 Dušan Milosavljević kundër EULEX-it. Më 29 qershor 2021, Paneli miratoi vendimin e tij mbi pranueshmërinë dhe meritat. Në vendimin e tij, Paneli përcaktoi që EULEX-i nuk kishte kryer ndonjë hetim efektiv për zhdukjen e anëtarit të ngushtë të familjes së ankuesit dhe nuk kishte informuar ankuesin. Si rezultat, Paneli vendosi që Misioni ishte përgjegjës për shkelje të pjesës procedurale të së drejtës së ankuesit për jetën, të garantuar me nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe për shkeljen e së drejtës së ankuesit për mos t'iu nënshtruar trajtimi çnjerëzor ose poshtërues, siç garantohet nga neni 3 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paneli i bëri disa rekomandime shefit të Misionit të EULEX-it, duke përfshirë që t'i pyes autoritetet se çfarë hapash janë ndërmarrë për të hetuar rastin dhe që t'u theksojë autoriteteve rëndësinë e të drejtave të viktimës për të vërtetën dhe që të informohet për rrjedhën e përgjithshme të hetimi. Paneli gjithashtu ftoi shefin e Misionit të kontaktojë ankuesin në mënyrë që të gjejë një mjet juridik për shkeljen e të drejtave të saj. Zbatimi nga ana e Misionit e atyre rekomandimeve është ende në pritje.

- Lënda 2016-22 Radmila Šapić kundër EULEX-it. Më 29 qershor 2021, Paneli ka lëshuar Vendimin dhe Gjetjet. Në vendimin e tij, Paneli vendosi që EULEX-i kishte dështuar të kryejë hetim efektiv për zhdukjen e anëtarit të ngushtë të familjes së ankuesit dhe kishte dështuar ta mbante të informuar ankuesin. Si rezultat, Paneli gjeti që Misioni ishte përgjegjës për një shkelje në pjesën procedurale të së drejtës së ankuesit për jetë, të garantuar me nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe për shkeljen e së drejtës së ankuesit për mos t'iu nënshtruar trajtimeve çnjerëzore e poshtëruese, siç garantohet me nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paneli i bëri disa rekomandime shefit të Misionit të EULEX-it, duke përfshirë që t'i pyes autoritetet se çfarë hapash janë ndërmarrë për të hetuar rastin dhe që t'u theksojë autoriteteve rëndësinë e të drejtave të viktimës për të vërtetën dhe që të informohet për rrjedhën e përgjithshme të hetimi. Paneli gjithashtu ftoi shefin e Misionit të kontaktojë ankuesin në mënyrë që të gjejë një mjet juridik për shkeljen e të drejtave të tij. Zbatimi i Misionit i atyre rekomandimeve është ende në pritje.

- Lënda 2016-32 Biljana Đorđević kundër EULEX-it. kundër EULEX-it. Më 26 mars 2021, Paneli mori vendimin dhe gjetjet e tij. Në vendimin e tij, Paneli vendosi që EULEX-i kishte dështuar të kryejë hetim efektiv për zhdukjen e anëtarit të ngushtë të familjes së ankuesit dhe kishte dështuar ta mbante të informuar ankuesin. Si rezultat, Paneli gjeti që Misioni ishte përgjegjës për një shkelje në pjesën procedurale të së drejtës së ankuesit për jetë, të garantuar me nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe për shkeljen e së drejtës së ankuesit për mos t'iu nënshtruar trajtimeve çnjerëzore e poshtëruese, siç garantohet me nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paneli i bëri disa rekomandime shefit të Misionit të EULEX-it, duke përfshirë që t'i pyes autoritetet se çfarë hapash janë ndërmarrë për të hetuar rastin dhe që t'u theksojë autoriteteve rëndësinë e të drejtave të viktimës për të vërtetën dhe që të informohet për rrjedhën e përgjithshme të hetimi. Paneli gjithashtu ftoi shefin e Misionit të kontaktojë ankuesin në mënyrë që të gjejë një mjet juridik për shkeljen e të drejtave të tij. Zbatimi i Misionit i atyre rekomandimeve është ende në pritje.

Vendimet përcjellëse

- Lënda nr. 2016-09 Slobodan Trifunović kundër EULEX-it. Më 29 prill 2021, Paneli miratoi një vendim pasues për zbatimin e rekomandimeve të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Si çështje paraprake, Paneli vuri në dukje se të drejtat e ankuesit në rastin në fjalë duket se ende shkelen pasi që rasti i të afërmit të tij të zhdukur mbetet i pa hetuar. Paneli konsideroi që hapat e ndërmarrë deri më tani ose të propozuara nga Misioni për të adresuar gjetjet dhe rekomandimet e Panelit nuk ofrojnë një përgjigje adekuate ose efektive ndaj shkeljes së të drejtave të ankuesit. Paneli ftoi Misionin të shqyrtojë edhe njëherë rekomandimet e Panelit që nuk janë zbatuar, dhe të informojë Panelin për

rezultatin e atyre shqyrtimeve. Paneli më tej ftoi Misionin të miratojë masa në përgjigje të rekomandimeve të Panelit që pasqyrojnë vërtet thellësinë e angazhimit të Misionit për të mbështetur standardet e të drejtave të njeriut dhe për të riparuar dëmin serioz të shkaktuar ankuesit në këtë rast. Paneli vendosi ta mbajë këtë lëndë të hapur për përcjellje të mëtejshme të mundshme.

- Lënda nr. 2016-10 Dragiša Kostić kundër EULEX-it. Më 29 prill 2021, Paneli miratoi një vendim pasues për zbatimin e rekomandimeve të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Si çështje paraprake, Paneli vuri në dukje se të drejtat e ankuesit në rastin në fjalë duket se ende shkelen pasi që rasti i të afërmit të tij të zhdukur mbetet i pa hetuar. Paneli konsideroi që hapat e ndërmarrë deri më tani ose të propozuara nga Misioni për të adresuar gjetjet dhe rekomandimet e Panelit nuk ofrojnë një përgjigje adekuate ose efektive ndaj shkeljes së të drejtave të ankuesit. Paneli ftoi Misionin të shqyrtojë edhe njëherë rekomandimet e Panelit që nuk janë zbatuar, dhe të informojë Panelin për rezultatin e atyre shqyrtimeve. Paneli më tej ftoi Misionin të miratojë masa në përgjigje të rekomandimeve të Panelit që pasqyrojnë vërtet thellësinë e angazhimit të Misionit për të mbështetur standardet e të drejtave të njeriut dhe për të riparuar dëmin serioz të shkaktuar ankuesit në këtë rast. Paneli vendosi ta mbajë këtë lëndë të hapur për përcjellje të mëtejshme të mundshme.

- Lënda nr. 2019-01 G.T. kundër EULEX-it. Më 29 prill 2021, Paneli miratoi një vendim pasues për zbatimin e rekomandimeve të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Paneli vuri në dukje se Misioni kishte ndjekur dhe zbatuar disa, por jo të gjitha rekomandimet e Panelit. Në veçanti, Paneli konsideroi që Misioni nuk e kishte pranuar shkeljen e të drejtave të ankuesit dhe nuk e kishte kontaktuar ankuesin drejtpërdrejt në lidhje me përcaktimin e nevojës për siguri shtesë që del nga dëshmia e ankuesit në Serbi. Paneli e ftoi Misionin edhe një herë të zbatojë këto dy rekomandime. Për më tepër, Paneli vuri në dukje se përgjegjësia për të siguruar ndonjë mjet efektiv juridik për shkeljet e të drejtave të kryera nga Misioni është dhe i mbetet vetë Misionit. Për aq sa Misioni, përmes shefit të Misionit, nuk është në gjendje ose nuk dëshiron të zbatojë plotësisht dhe tërësisht rekomandimet korrigjuese të Panelit, mbetet përgjegjësia e tij për të gjetur mjete alternative dhe mënyra lehtësimi që ofrojnë ndonjë mjet efektiv juridik për shkeljet që konstatohet se ka kryer. Paneli vendosi ta mbajë këtë lëndë të hapur për përcjellje të mëtejshme të mundshme.

Publikimi i vendimeve

Të gjitha vendimet e Panelit janë publikuar në faqen e internetit të Panelit në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe dhe gjendet në: www.hrrp.eu.

Vizitoni faqen tonë të internetit: www.hrrp.eu.

HRRP
Human Rights Review Panel
Human Rights Review Panel
Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut
Komisija za Razmatranje Ljudskih Prava

Visit us on Facebook

SI TË PARASHTROHET ANKESA NË PShDNj

(Rregullat 25 dhe 26 të rregullores së punës të PShDNj-së)

Kush?

Çdo person i cili nuk punon për misionin e EULEX-it në Kosovë, i cili ankohet se ka qenë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e misionit të EULEX-it Kosovë gjatë zbatimit të mandatit ekzekutiv të tij.
Ankuesi (personi që e bën ankesën) mund të përfaqësohet nga ndonjë avokat ose përfaqësues tjetër sipas dëshirës së tij ose saj. Në këtë rast duhet të plotësohet autorizimi.

Çka?

Paneli do t'i shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me këto shkelje të dyshuara, të cilat kanë ndodhur në Kosovë pas datës 9 dhjetor 2008. Shkelja duhet të jetë shkaktuar nga Misioni i EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit ekzekutiv të tij.
Paneli nuk i shqyrton procedurat gjyqësore të kryera nga gjykatat në Kosovë.

Kur?

Ankesa duhet t'i parashtrohet Panelit brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së dyshuar.

Si?

Ankesa duhet të parashtrohet me shkrim. Ankesa nuk mund të bëhet me telefon. Ankuesi mund ta përdorë gjuhën angleze, shqipe ose serbe. Normalisht, ankesa duhet të plotësohet në formularin përkatës dhe të shoqërohet me dokumente dhe vendime përkatëse (nëse ka), sipas udhëzimeve në formular.
Nëse ankesa paraqitet në letër, në të duhet të përcaktohet, të paktën në formë të përmbledhur, lënda e ankesës në mënyrë që ajo të shqyrtohet më tej.

Ku?

Ankesa mund të parashtrohet në:

Visit us on Facebook

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut - sekretariati
Rr. Rrustem Statovci nr. 29 – 10000 Prishtinë – Kosovë
Tel: +381 (0) 38 28 2207
Ankesa gjithashtu mund të parashtrohet përmes postës elektronike në: office@hrrp.eu
www.hrrp.eu

Nëse ankesa parashtrohet përmes postës elektronike, atëherë ankesa origjinale e nënshkruar duhet të dorëzohet brenda katër javëve nga data e dërgimit të postës elektronike.

Plotësimi i formularit për ankesë

Ankesa duhet të shkruhet qartë dhe lexueshëm, dhe mundësisht të jetë e shtypur me kompjuter. Formulari duhet t'i përfshijë të gjitha hollësitë kontaktuese të ankuesit. Nëse ankesa përmban fakte të dokumentuara, duhet të paraqiten kopjet e lexueshme. **Mos i dërgoni dokumentet origjinale**.

Dokumentet duhet të renditen sipas datës dhe të shënohen me numra rendor të njëpasnjëshëm dhe me një përshkrim të shkurtë (p.sh. letër, urdhër, vendim, ankesë, etj.).

Gjatë regjistrimit ankesës i caktohet numri i dosjes. Numri i dosjes duhet të përmendet në të gjitha korrespondencat vijuese. Nëse ankuesi tashmë e ka një ankesë, e cila është duke u shqyrtuar nga Paneli, ai/ajo duhet ta informojë Panelin lidhur me numrin e dosjes së mëparshme. Nëse ankuesi për arsye të ndryshme nuk dëshiron që identiteti i tij/saj të bëhet publik, ai/ajo duhet ta plotësojë pjesën përkatëse në formularin e ankesës.